



BURSA STUDIMI PASUNIVERSITARE NË FRANCË,

VITI AKADEMIK 2018-2019

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se për kandidatët e huaj që dëshirojnë të studiojnë në Francë, Qeveria e Republikës së Francës për vitin akademik 2018-2019 ofron bursa pasuniversitare në programe studimi: **Master** dhe **doktoratë** për shtetasit shqiptarë, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet publike franceze. Konkretisht, bursat për studime pasuniversitare ofrohen sipas kategorive në vijim:

- **10 (dhjetë) bursa studimi Master**, jo më shumë se 10 muaj (shtator 2018 - qershor 2019). Bursa mujore mbulon shpenzimet e ushqimit, asistencë për akomodim, tarifën e regjistrimit dhe të shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë dhe siguracionin shoqëror. Shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga vetë kandidatët.
- **5 (pesë) bursa studimi Master**, jo më shumë se 10 muaj (shtator 2018 - qershor 2019). Bursa siguron mbulimin e shpenzimeve shoqërore/mjekësore; përjashtim nga tarifa e regjistrimit në institucionet publike të arsimit të lartë; sigurim shoqëror, asistencë për akomodim. Bursa nuk përmban pagesë mujore, POR, mbulon shpenzimet e një bilete avioni vajtje-ardhje me avion.
- **1 (një) bursë doktoratë për** periudhën shtator 2018 - gusht 2021. Bursa në “*co-tutelle*” përfshin **15 muaj mobiliteti** të shpërndara në 3 vite të njëpasnjëshme akademike. Bursa përfshin pagesën mujore si dhe siguracionin shoqëror. Bursa nuk mbulon shpenzimet e transportit ndërkombëtar.

Bursat e studimit, për sa më sipër, ofrohen kryesisht në fushat e mëposhtme:

- -Klimë;
- -Biodiversitet;
- -Mjekësi;
- -Energji;
- -Migracion.

Krahas aplikimit *online*, kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë pranë zyrave të Shërbimit, të Bashkëpunimit dhe Veprimtarive Kulturore të Ambasadës Franceze në Tiranë dokumentet, sipas listës në vijim:

1. Formularin e aplikimit që gjendet në sistemin *online* ose bashkëlidhur këtij njoftimi;
2. Kopjen e diplomës më të lartë dhe listat e notave (dokumente të përkthyer dhe të noterizuara);
3. Dokumentin që vërteton njohjen e gjuhës frënge/ose angleze (B2) sipas programit master ose tezës në doktoratë;
4. Një CV për ciklet e shkollimit dhe adresat e shkollave ku kandidati ka studiuar në gjuhën frënge/ ose angleze sipas programeve të studimit të ofruara;
5. Letrën e motivimit në frëngjisht ose në anglisht për të prezantuar projektin e studimit në Francë;
6. Marrëveshjen “*co-tutelle*” për tezën e doktoratës ;

7. Letra/t e rekomandimit nga drejtuesi/t dhe/ose pedagogu i institucionit nga vjen kandidati ;
8. Vërtetimin e regjistrimit ose kopje të korrespondencës të kandidatit me universitetin francez;
9. Kopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit ;

Dokumentet do të shqyrtohen nga Zyra e Shërbimit për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturere në Ambasadën Franceze në Tiranë.

Kandidatët që do të dorëzojnë dosje të paplota me mungesa në dokumentacion do të skualifikohen nga procedura e aplikimit.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentave në Ambasadën Franceze në Tiranë është data **31 maj 2018** në adresën e mëposhtme:

*Ambasada e Francës
Shërbimi për Bashkëpunim dhe Veprimtari Kulturere
Rruga Skënderbej Nr. 14,
Tiranë*

Kandidatët fitues për bursat e studimit të ofruara nga qeveria franceze do të shpallen gjatë muajit korrik 2018.

Formularët e aplikimit gjendet bashkëlidhur këtij njoftimi.

Gjithashtu, për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresave në web-site:

<https://al.ambafrance.org/Bursa-te-qeverise-franceze-per-Mastera-dhe-Doktoratura#bursa-qeverise-franceze-per-mastera;>

<https://al.ambafrance.org/Bourses-du-Gouvernement-Francais-pour-les-Master-2-et-Doctorat-2018-2019>.

Email: kleopatra.koleka@diplomatie.gouv.fr

Email: valbona.nano@diplomatie.gouv.fr

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS